

**5** minuta  
vlejnë  
sa një  
**JETË**



**SQ**

**KONTROLLI I QAFËS SË MITRËS  
NË EMILIA ROMAGNA**

## **ÇFARË ËSHTË KONTROLLI I QAFËS SË MITRËS?**

Kontrolli mundëson **parandalimin e kancerit të qafës së mitrës** përmes trajtimit të lezioneve parakanceroze që mund të zhvillohen në kancer dhe redukton vdekshmërinë përmes **zbulimit të hershëm** të kancerit të qafës së mitrës.

Kontrolli është për të gjitha gratë që janë rezidente, me vendbanim dhe nën përkujdesje në Emilia-Romagna, të cilat janë të ftuara të bëjnë një Pap test çdo tre vjet për moshat 25 deri 29 vjeç (nëse nuk janë vaksinuar kundër HPV-së) dhe një test HPV çdo pesë vjet për moshat 30 deri 64 vjeç. Testi i kontrollit është **i thjeshtë, falas dhe zgjat vetëm pak minuta.**

## **PËRSE TË BËHENI PJESË E KONTROLLIT?**

Për t'u kujdesur për veten dhe shëndetin, si rezultat i kontroleve, **kanceri i qafës së mitrës është rralluar më shumë.** I gjithë **procesi i kontrollit është falas dhe i organizuar**, nga testimi në çdo trajtim e deri në monitorimet e mëpasme.

**FALË KONTROLLIT TË QAFËS SË MITRËS**

**- 40%**  
raste të reja  
kanceri

**- 50%**  
vdekshmëri

## **ÇFARË ËSHTË PAP TESTI?**

Pap testi konsiston në **mbledhjen delikate të gelizave** nga qafa e mitrës, me një spatul të vogël dhe furçë; materiali analizohet më pas nën mikroskop për të zbuluar **ndryshime të mundshme** të shkaktuara nga virusi HPV.

## **ÇFARË ËSHTË TESTI HPV?**

Testi HPV kryhet në materialin e marrë njësoj si në rastin e Pap testit dhe **kërkon për praninë e llojeve të caktuara të papilloma virusit (HPV me rrezikshmëri të lartë)**, shkak i një infeksioni shumë të zakonshëm të transmetueshëm seksualisht. Shumica e grave shërohen vetë (nuk ka asnjë trajtim efektiv), por nëse mbetet aty, në raste të rralla virusi mund të shkaktojë leziona në qafën e mitrës që zhvillohen ngadalë në kancer.

## **PSE TESTI HPV OFRON MBROJTJE MË TË MIRË SE PAP TESTI?**


Shumë studime kanë treguar se, krahasuar me Pap testin, testi HPV **gjen më shumë leziona të qafës së mitrës dhe më shpejt.** Për këtë arsye është e mjaftueshme ta përsërisni çdo pesë vjet, në ndryshim nga Pap testi çdo tre vjet.

## **PSE REKOMANDOHET TESTI HPV VETËM NGA MOSHA 30 VJEÇ E LART?**

Sepse tek gratë e reja infeksionet me HPV janë shumë të zakonshme, por **në shumicën e rasteve ato shërohen vetë.** Kontrolli i HPV-së tek gratë nën 30 vjeç çon në gjetjen e më pas në trajtimin e lezioneve që, përndryshe, do të ishin shëruar vetë.

Falë mbrojtjes efektive nga vaksina e HPV-së, të gjitha vajzat e lindura nga viti 1998 e tutje që kanë marrë dy doza të vaksinës para moshës 15-vjeçare do të ftohen për kontrollin e tyre të parë në moshën 30-vjeçare dhe jo më 25-vjeçare.


## JENI NGA 25 DERI 29 VJEÇ DHE NUK KENI BËRË VAKSINË?



\*Kolposkopia është një kontroll falas dhe pa dhimbje për zbulimin e lezioneve që kanë nevojë për trajtim.

**Kontrolli nuk mund të zbulojë sëmundje të tjera gjinekologjike:** bëni kujdes nëse keni simptoma ose shqetësime dhe, nëse nevojitet, këshillohuni me një specialist të shërbimit mjekësor.

## JENI NGA 30 DERI 64 VJEÇ?



### KONTROLLI IDENTIFIKON:

- 1 test HPV pozitiv për çdo 12 gra të testuara
- 1 lezion parakanceröz për çdo 132 gra të testuara
- 1 tumor për 5000 gra të testuara

Paraqituni për vizitën: pesë minuta, një shqetësim më pak.

## PO KËRKONI MË SHUMË INFORMACION?

Vizitoni faqen



Mund të na telefononi gjithashtu në



nga e hëna më të premte, ora 8:30 - 18:00  
E shtunë: 8:30 - 13:00